



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXXVI-të (tridhjetë e gjashtë – mandati VI) e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 16 korrik 2021

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, përfaqësuesit nga OJQ “Voice of Roma, Ashkalinj dhe Egjiptas) z. Muharrem Asllani, dhe z. Avni Avdiu, si dhe z. Besnik Muçaj nga Organizata KLGI.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i falënderuar për pjesëmarrje, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje e keni marr me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë, nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete të mbajtur më 07 qershor 2021

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali sipas kësaj pike të rendit të ditës

2. Senzibilizimi dhe mbështetja e nxënësve të Komuniteteve jo shumicë sa i përket regjistrimit në shkollat e mesme të larta në Komunën e Podujevës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, pra siç e dimë pandemia ka shkaktuar pasoja edhe në çështjen e arsimit dhe në përgjegjësi shumica e të gjithëve por ndoshta më të prekurit kanë qenë nxënësit e komuniteteve dhe kjo ka ndikuar që në mësimnxënie dhe arritjet e tyre por edhe në teste siç është tani testi i maturës për nxënësit e shkollave të mesme, për të mos humbur më shumë kohë ia kisha kaluar fjalën z. Avni Fetahu drejtor i DKA-së për të dhënë më shumë informata rreth kësaj teme.

z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, theksoi, informatat e detajuara lidhur me pranimin e nxënësve në shkolla janë në përpunim e sipër dhe në seancën e ardhshme të Kuvendit parashihet një informatë e përgjithshme dhe do të plasohen edhe ato informatat mbi numrin e të regjistruarve. Ajo çka është me rëndësi është se dy qendrat mësimore që kanë qenë të parapara të funksionalizohen për fat të mirë me një angazhim të përbashkët prej Kryetarit dhe DKA e gjithashtu në këtë projekt është involvuar edhe Nënkryetarija e Kuvendit të Kosovës znj. Saranda Bogujefci dhe kemi arritur një marrëveshje e cila siç e dini ka ndenjur që 2 vite radhazi vetëm e nënshkruar dhe pa zbatuar. Pra Marrëveshja do të fillojë së zbatuari prej muajit shtator, mjetet financiare është dakorduar që t'i siguroj organizata në fjalë e cila i deponon deri në muajin dhjetor, dhe prej muajit janar është zotuar Kryetari i Komunës që do të vazhdojë t'i paguaj mësimdhënësit për nevojat që i kanë Komunitetit jo shumicë. Në të njëjtën kohë ju e dini që kemi pranuar një donacion prej 2000 € për qendrat në fjalë dhe ato qendra duam që t'i funksionalizojmë edhe më shumë, krahas kësaj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal kemi bërë një kërkesë për ndërtimin e një qendre të re, jo ndaras, por afër shkolle në mënyrë që aktiviteti i këtij komuniteti me qenë i jetësuar edhe me komunitetin shumicë, kështu që jemi në përpjekje me krijua kushte sa më të përshtatshme për komunitetin jo shumicë. Pra këto janë disa informata në pika të shkurtra, çfarëdo informate tjetër që mund të kërkonin unë jam i hapur për atë sa kam njohuri mund të ju informojë.

znj. Doruntina Hasani, theksoi, më duket se nuk i kemi informacionet sa nxënës të komunitetit jo shumicë janë regjistruara në shkolla të mesme apo që kanë mundur të regjistrohen, çështje për të cilën dëshiroj ta di edhe nga Kryesuesja e Komitetit se a ka informacione rreth kësaj dhe po ashtu kërkoj nga kryesuesja që ë na tregonte se a ka pasur diçka më herët që i ka sensibilizuar ose inkurajuar nxënësit e komunitetit jo shumicë që të regjistrohen në shkolla të mesme.

z. Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, nëse ka edhe ndonjë pyetje tjetër unë së shpejti i nxjerr informatat të sakta për numrin e të pranuarve, vetëm deri sa të më shkarkohet lista.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, atëherë sa i përket Komunës së Podujevës dhe lagjeve ku banojnë komunitetet Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptianë ka pasur kampanja vetëdijësuese dhe thirrje për regjistrimin e nxënësve në shkolla të mesme, nga organizata të ndryshme e posaçërisht nga organizata "Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasëve". Siç e ceku edhe drejtori i DKA z. Avni Fetahu kanë qenë dy qendra për mësim shtesë ku janë mbajtur aktivitetet të ndryshme dhe janë sensibilizuar dhe informuar edhe prindërit për regjistrimin e fëmijëve në shkolla por edhe në shkolla të mesme, sa i përket Komunës nuk e di, nuk kam njohuri dhe me sa e di nuk kanë pasur ndonjë aktivitet për një gjë të tillë përveç organizatave dhe shoqërisë civile të cilat kanë bërë thirrje për regjistrim e nxënësve në shkolla fillore por edhe në ato të mesme.

z. Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa për informatën e juaj ka një ngritje në bazë të të dhënave zyrtare meqë janë duke i përpunuar zyrtarët dha jam në dijeni, në edukimin para fillor janë 10 nxënës prej komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptasë, në arsimin fillor janë 97 nxënës të komuniteteve jo shumicë ashtu siç i kanë ofruar të dhënat, si dhe pastaj në arsimin e

mesëm janë 59 nxënës, do të thotë kemi këto 3 kategori që janë regjistruar, dhe atë; në shkolla të mesme 59, në arsimin fillor 97, dhe në edukimin para shkollor 10 nxënës.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, nëse ka dikush diçka të shtoj rreth kësaj informate, ose ndonjë pyetje tjetër urdhëroni, nëse jo atëherë unë kam një pyetje për z. Avni Fetahu me që po bisedojmë për mbështetjen dhe siç e dimë ka qenë një sfidë edhe për ju sepse pandemia ka shkaktuar shumë probleme ndoshta, pra a keni ndonjë program ose ndonjë zgjidhje se si do t'i mbështetni tani nxënësit sa i përket regjistrimit të tyre çoftë në shkolla fillore dhe në ato të mesme, si do t'ju ofroni mbështetje dhe si do t'ju bëni zgjidhje për një mundësi më të mirë.

z. Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, ajo që kemi vërejtur tek ky komunitet është kryesisht çështja e transportit, përkundër faktit që nuk kanë një distancë shumë të madhe sërish e shohin si problem transportin e tyre, pa dashur të arsyetohem, mirëpo siç e dini në secilën Drejtori kemi gjetur një buxhet të planifikuar tanimë dhe nuk kemi mundësi që të kategorizojmë prej investimeve tjera kapitale për një kategori tjetër, por ajo që kemi menduar për këtë komunitet është që të sigurojmë transportin, t'iu krijojmë kushte të vijnë deri në shkollë, në emër të sigurisë sepse përndryshe në Udhëzim Administrativ është e përcaktuar që duhet të jenë 4 kilometër distanca, mirëpo duke marr parasysh inkurajimin e tyre për të vijuar shkollimin e kemi menduar variantin ose të sigurojmë transportin ose të veprojmë sikurse Prishtina që të participojnë me subvencion një pagesë simbolike sa mund të i kushtoj transporti të dy anshëm me qëllim të vijimit sa më të madh të nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla, domethënë një nxitje për me ardh në shkollë. Në shkolla duhet me fillu me u ambientu me kushtet me të cilat jeton edhe komunitetit shumicë, do të thotë ato që i kemi për komunitetin shumicë i kemi edhe për komunitetin jo shumicë, pa të mos bëhen dallimi, kjo është e rëndësishme që të inkurajohen siç e cekta edhe më parë të sjellën deri në shkollë, kurse për çështje tjera është çështje procedurale e mësimdhënies dhe mësimnxënies, interesimi i tyre i mbajtjes së mbledhjeve me këshill të shkollave, angazhimin edhe të prindërve të tyre në këshill të shkollës në mënyrë që ata me marr një përgjegjësi dhe rëndësi në lidhje me arsimin, dhe kjo mendoj që ndikon pozitivisht.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, sa i përket regjistrimit të nxënësve të komunitetit jo shumicë nëpër shkolla të mesme, a ka pasur ndonjë lehtësim për shkak se e dimë që mungesa e pajisjeve teknologjike ndoshta ka ndikuar që mos me mbërri në mësimnxënie, dhe pastaj kushtet socio ekonomike a ka për të pasur diçka të tillë prej Drejtorisë.

z. Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, literaturën e kanë siguruar edhe prej Ministrisë së Arsimit, është me Udhëzim Administrativ kjo çështje.

Pa dashur të bëjë dallime e them se krahas kësaj ata kanë pasur dhe kanë shumë mundësi tjera, mirëpo po të shikohen qendrat e aftësimin, i kanë më pajisura se të tjerat, kanë lodra, një varg dokumentesh dhe librash, sesa në atë ne ku veprojmë, mirëpo ka qenë pak kështu që ka qenë mundësia që me u furnizu më lehtë.

Sa i përket teknologjisë informative, ne jemi në procedurë të prokurimit edhe për 60 lloptop tjerë dhe kemi menduar që të përfitojnë edhe nga komuniteti në këtë fond të këtyre lloptopëve.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, nëse ndokush ka diçka për të shtuar rreth kësaj teme urdhëroni, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, vazhdojmë me piken e radhës.

3. Informatë e Organizatës Joqeveritare “Zëri i Romëve Ashkalinjve dhe Egjiptasve” rreth Sesionit informues për antigjipsizëm

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, sa i përket kësaj pike, prezent i kemi përfaqësuesit e organizatës VORAE, andaj sipas kësaj pike, ia kaloj fjalën z. Muharrem Asllani.

z. Muharrem Asllani, përfaqësues i organizatës VORAE, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, unë jam shumë mirënjohës që sot jam në mësim e juaj dhe kam mundësi të prezantoj në Komitetin për Komunitet çështjet që Organizata jonë i praktikon, mirëpo duke parë bashkëpunimin e ngushte me Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe angazhimin e Organizatës Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve që kanë përmirësuar qasje të komunitetit RAE në institucionet dhe duke qenë pjesë e qytetarisë në Komunën e Podujevës ne kemi shprehur gatishmëri që sot të jemi së bashku me ju dhe t’i ndajmë disa informata.

Për ata që nuk më njohin, unë jam Muharrem Asllani jam zyrtar në kuadër të Organizatës Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptasve, jam zyrtar në kuadër të projektit “Antigjipsizëm” një projekt që është krejtësisht i ri në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë por edhe në Ballkan, jemi Organizata e parë në Ballkanin Jugperëndimor që implementojmë një projekt të tillë, projekt i cili financohet prej Bashkimit Evropian dhe është projekt për 9 vitet e ardhshme.

Ne me Komunën e Podujevës kemi një Memorandum Bashkëpunimi të nënshkruar bashkë me Kryetarin e Komunës dhe kemi arritur në një pikë të dakordimit që të gjitha aktivitetet t’i bashkërendojmë bashkërisht si Organizatë e shoqërisë civile dhe nivel Komunal, varësisht prej Drejtorive gjegjëse ose dikastereve që do të jenë përgjegjës për fushat përkatëse dhe të implementojmë projektin së bashku, me të vetmin qëllim që edhe pjesëtarët e këtyre grupeve të cenueshme etnike në Kosovë e veçanërisht në Komunën e Podujevës të jem pjesë integruese e shoqërisë Kosovare, domethënë kur flasim për Komunitetet të mos flasim, komuniteti juaj ose komuniteti jonë por të flasim për një shoqëri të përgjithshme të edukuar dhe të emancipuar, pra kjo është e gjithë ideja e projektit edhe e organizatës sonë.

Ne e dimë që më herët me qeverinë e kaluar të nivelit lokal keni pasë disa mos pajtime nëse mund t’i quaj ashtu ngase edhe pse Drejtoria Komunale e Arsimit është zotuar që Qendra për mësimnxënie në Komunën e Podujevës t’i mbështes, është ndërprerë një punë jashtëzakonisht e mirë e cila vetëm që është dashur një vullnet politik sepse nuk ka munguar diçka tjetër, buxhetin ne e kemi siguruar për mediatorët ose asistentët të mësuesve që kanë qenë në kuadër të shkollave me çka i kemi mbështetur me paga, dhe i kemi mbështetur me të gjitha çka duhet për ato qendra, mirëpo nuk ka pasur një vullnet të mirëfilltë politik dhe unë po besoj që tani me qeverinë e re në kuadër të Komunës së Podujevës ia kemi arritur deri tek një Marrëveshje paraprake të cilën edhe drejtori parafolës i DKA-së e potencoj, e që unë jam shumë falënderues, mirëpo edhe nga ana jonë është një që ne e kemi jap maksimumin dhe sërish do ta japim me të vetmin qëllim që edhe grupet etnike minoritare jo vetëm në Komunën e Podujevës por në të gjitha Komunat tjera të jenë pjesë integruese e shoqërisë Kosovare, pra ideja është që kjo Kosovë të thirret në multi-funksionalitet, në realizim dhe të konsiderohet si pasoj ose vlerë e shtuar e shoqërisë Kosovare dhe ne ashtu po duam ta trajtojmë dhe ta bëjmë ta bashkërendojmë.

Ne sot në kuadër të këtij takimi që është Komiteti për Komunitete, po diskutojmë për një fenomen që është krejtësisht i ri qoftë edhe në aspektin terminologjik është krejtësisht i ri, mirëpo si problematikë është diçka që është e trashëguar prej sistemeve të kaluara. Kur bëhet fjala për antigjipsizëm unë po e them si nocion dhe si terminologji është e re, mirëpo si problematik daton qysh herët dhe është një fenomen që përcjell shoqërinë Kosovare në të gjitha Komunat, mirëpo në Komunën e Podujevës nuk është shumë e theksuar, nuk është shumë

shqetësuese, mirëpo çka do që është ne së bashku po duam ta luftojmë dhe ta eliminojmë dhe me shërbyer ndoshta Komuna e Podujevës si model për Komunitet e tjera sepse komuniteti kryesisht ashkalinjë që është në Komunën e Podujevës është komuniteti me më së shumti numër të banorëve dhe është i integruar jashtëzakonisht mirë, ndoshta me një përfaqësim në nivelin lokal po besoj që Komuniteti do të jetë i barabartë, domethënë me të gjitha komunitetet e tjera dhe nuk kishte me pasur vështirësi pastaj edhe t'i adresojmë problemet me çka ballafaqohemi.

Kur flasim për komunitetet ne e dimë që në Kosovë jetojnë më shumë apo mbi 35000 pjesëtar të këtyre komuniteteve dhe komunitetet është mirë të përcaktohen si komunitete të ndara sepse në disa komuna po e kemi shumë problematik në mungesë të informacionit se Komunitetet Romë Ashkalinjë dhe Egjiptianë janë një komunitet sepse Kushtetuta e Kosovës i kategorizon si grupe të veçanta etnike dhe po besoj që edhe ne ishte dashur që në të njëjtën formë t'i trajtojmë ashtu siç janë të parapara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh situatën e tyre sociale, problemet socio-ekonomike, niveli i ulët i edukimit, infrastruktura e dobët e banimit, lagjet jo formale e bëjnë shumë më të vështirë jetën e këtyre banorëve. Në Komunën e Podujevës kemi dy lagje që banojnë këto komunitete dhe jo që është një gjendje e rëndë sepse i kam vizituar dhe i di për çdo shtëpi kam punuar në teren nuk them që është një gjendje e rëndë, por a mundemi t'i përmirësojmë dhe ndryshojmë, po, definitivisht ka hapësirë për përmirësim dhe ndryshim dhe unë po besoj që me një vullnet të mirëfilltë të shoqërisë civile, qytetarëve dhe vet banorëve të këtyre 3 komuniteteve edhe niveli komunal po besoj që kishte me mund me bë një zgjidhje ideale për t'i tejkaluar të gjitha këto problematika. Sido që të jetë fenomeni i antigjipsizmit është i pranishëm në gjithë Kosovën por edhe në Podujevë, një prej problemeve që i kemi diskutuar edhe me Kryetarin e Komunës dhe Nënkryetaren e Komunës kemi hasur disa pengesa ose barriera që iu ofrohen komuniteteve, kemi dalë nëpër lagje kemi vizituar bashkë me Kryetarin të gjitha lagjet e këtyre komuniteteve dhe kemi parë që komunitetet nuk janë shumë të inkuadruar në shoqërinë kosovare e veçanërisht në Komunën e Podujevës. E thash edhe më herët pjesëmarrja e ulët në arsim ashtu siç e diskutuam edhe më herët, niveli i lartë i papunësisë i këtyre komuniteteve, infrastruktura e dobët dhe vendbanimet jo formale jetën e këtyre 3 komuniteteve e bëjnë më të vështirë dhe kjo e ndanë prej shoqërisë. Në përgjithësi këto janë disa prej shkaqeve që neve na obligojnë për të punuar dhe për t'i adresuar këto problematika.

Sa i përket arsimin, ne e diskutuam se ne si Organizatë jemi zotuar se kemi me i mbështet mediatorët me paga dhe buxhetin kemi për ta kaluar tek Komuna dhe pastaj Komuna me iu nda ato paga mediatorve, është një diçka tepër e rëndësishme dhe që ia vlen të përmendet që është duke u siguruar hapësira në kuadër të këtyre shkollave ku frekuentohen pjesëtarët e këtyre 3 komuniteteve dhe kjo është me rëndësi që fëmijët nuk do të jenë të ndarë në aspektin e objekteve shkollore por me qëllim të gjithë përfshirjes, është paraparë që këtu të jenë qendra të mësimnxënies dhe të jenë brenda objekteve shkollore.

Nëse flasim për antigjipsizëm neve na bënë me kuptu që antigjipsizmi nuk është asgjë tjetër përveç që është formë specifike e racizmit, domethënë antigjipsizmi si terminologji nuk do të thotë që është e re, mirëpo si problematikë është diçka që na ka përcjell qysh edhe më herët dhe është trashëguar brez pas brezi, dhe ne tani çfarë po duam është ta luftojmë këtë formë të racizmit. Antigjipsizmi në Kosovë nuk ka tjetër përmbajtje përveç që është formë specifike e racizmit dhe një ideologji e bazuar në superioritetin racor në formë të dehumanizimit dhe racizmit institucional i ushqyer nga diskriminimi historik, atë që e thashë që është trashëguar brez pas brezi. Fjala antigjipsizëm përdoret për të përshkruar qëndrimet, sjelljet dhe strukturat që janë kundër grupeve etnike në Kosovë siç janë Romët, Ashkalinjët dhe Egjiptianët, mirëpo

antigjipsizmi e ka për target fjalët ofenduese që përdoren karshi këtyre 3 komuniteteve siç është akronimi “RAE” ose siç janë fjala “magjup”, fjala “cigan” domethënë qëllimi ynë si Organizatë dhe Memorandumit të Mirëkuptimit që e kemi nënshkruar me Komunën e Podujevës ka të bëjë me luftimi e termave ofendues që adresohen karshi këtyre 3 komuniteteve dhe edhe me nivelin qendror – Zyrën e Kryeministrit kemi një Marrëveshje, pastaj kemi Marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë, kemi një Marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe në këto sesione informuese kanë kaluar disa zyrtar publik të Komunës së Podujevës, kemi mbajtur 2 sesione informuese ky është sesioni i 3-të dhe po mendojmë që sesionet informuese me i mbajtë edhe me QKMF-të në kuadër të Komunës së Podujevës edhe me Policinë e Kosovës, mirëpo edhe me vet Komunitetin sepse më shumë se Komuniteti që munde të llojoj për luftimin e antigjipsizmit nuk mundet askush tjetër, mirëpo nëse duhet dikush i dytë me qenë janë institucionet e nivelit lokal dhe nivelit qendror.

Nëse flasim për fjalën që e përmenda “magjup” ose gjuhen e urrejtjes ndoshta më mirë me zbut këtë terminologjie, shohim se nganjëherë edhe pa vetëdije ose pa dashje dëgjojmë shumë herë në publik që adresohen këtyre Komuniteteve me fjalët “magjup”, “Cigan”, “Gabel”, ka disa fjalë që iu adresohen këtyre 3 Komuniteteve mirëpo e gjithë esenca është që edhe këto sado të vogla që janë këto problematika me mund me i luftu dhe me i adresua deri në atë nivel që me u ndërjegjësua opinioni i gjerë dhe të mos përdoren terma ofenduese. Mua më kujtohet vetëm një rast po dua ta përmend, kur kam qenë në shkollën e mesme kur na thonin serbët se ju jeni “shiftari” ne prej inatit si nxënës nuk dinim çfarë të bënim qanim sepse shumë ofenduese me të thënë dikush “shifter”, dhe tani përderisa, shembull, komuniteti shqiptar ka qenë i diskriminuar me shekuj të tërë prej regjimit serb-jugosllav pse ne tani si shoqëri duhet të bëhemi dhe të verojmë ashtu, unë e di se në shumicën e rasteve bëhet pa një vetëdije apo qëllim për ta ofenduar ndokënd, mirëpo edhe nëse ndodh unë po them nuk bënë të ndodh ashtu, mua më ka ndodhur rasti gjatë kohës së daljes në pauzë kur kam punuar në MAPL në cilësinë e ekspertit për reformë në administratë publike, dhe të dy shokët e mi që shih shqiptar, njëri-tjetrit po i thotë pse po pinë cigare si magjup, paramendoni tani se ata dy asnjëri nuk ishin “magjup” dhe shpreheshin kështu gjëra të ngjashme, por ideja është se gjithçka çka është e keqe referohet me fjalën “magjup”, ose fëmijëve kur i vënë në gjumë nënat shumë herë i thonë flejë se ka për të ardh me të marr një “magjup”. Janë disa problematika që duhet t’i adresojmë dhe me mund me i tejkalua.

Sa i përket kornizës ligjore, ne në Kosovë mund lirshëm të themi që Kosova është model jo vetëm për Evropën por edhe në kontinentet e tjera jashtë Evropës sepse sa i përket infrastrukturës ligjore është i vetmi shtet Kosova që ka Ligje të veçanta, specifike për grupet etnike, pastaj përveç ligjeve kemi edhe Kushtetutën e cila në një kapitull të tërë i Kushtetutës së Kosovës flitet për grupet minoritare apo për komunitetet siç është Kapitulli III-të neni 65, do të thotë i kushtohet komplet komuniteteve Romë, Ashkalinjë dhe Egjiptian.

Përveç qytetarisë aktive që e thashë edhe më herët, mediat kanë një rol të fuqishëm në luftimin apo edhe në nxitjen e urrejtjes sa i përket antigjipsizmit sepse media konsiderohet që është shtylla e 4-të e pushtetit dhe këto portale tani që na kanë vërshuar, e shohim që nëse e marrim një rast, një qytetare e Komunës së Podujevës e cila ka qenë e kthyer prej Belgjikës dhe është dal në qytezën e Lipjanit për të shëtitur, është sulmuar gjoja se mediat kanë përhapur lajm të gabuar se ajo po i kidnapon fëmijët e komunitetit Shqiptar dhe është sulmuar fizikisht, pastaj prej aty ka kaluar në qytetin e Ferizajt dhe njëjta gjë i ka ndodhur edhe në qytetin e Ferizaj vetëm pse media e kanë adresuar gabimisht si problematikë, por unë po dua të them që media e ka një ndikim shumë të madh sesi e adreson një problematikë, dhe dinë edhe me i shtrembëruar në shumicën e rasteve, nëse e marrim dhe e shohin rastin e George Floyd në Amerikë ju mund të vëreni qse

çfarë roli ka pasë media për me ekzagjerua apo me e rritë si problematik atë çfarë ka ndodhur me George Floyd në Amerikë, dhe këtu tek ne fatkeqësisht po them ka media dhe portale të cilat nuk janë të licencuara dhe nuk janë të akredituara dhe nuk kanë staf profesional, dhe kjo e bënë Komunën të vështirë sa i përket komunitetit.

Unë këtu kisha me përfundua sepse nuk po dua të marr më shumë kohë, mirëpo nëse ka ndokush diçka të shtoj ose të diskutoj ndihuni të lirë për këtë që e kemi ndarë me juve, ne e kemi përgatitur një material që ju të keni informatë shtesë, z.Avni Avdiu është mediator për Komunën e Podujevës dhe çka do që ka nevojë po besoj që mundeni me adresua në nivel Komunal, kurdoherë që paraqitet nevoja me mbështet në çfarëdo forme që i përket komuniteteve ne jemi të gatshëm si organizatë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, falënderoj z.Muharrem Asllanin për informatat dhe sqarimet e dhëna rreth kësaj çështje dhe aktiviteteve të Organizatës në fjalë. Urdhëroni nëse ka të interesuar për të marrë fjalën, nëse jo kalojmë në pikën e radhës.

4. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0061322/21
Podujevë, 16 korrik 2021**

**Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu**